

VENDIM
Nr. 143, datë 24.2.2016

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 460, DATË 22.5.2013, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, RREGULLAVE DHE
PROCEDURAVE TË DHËNIES ME QIRA TË TOKAVE BUJQËSORE
NË PRONËSI TË SHTETIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 9, 10 e 15, të ligjit nr. 8318, datë 1.4.1998, “Për dhënie me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve dhe kullotave, që janë pasuri shtetërore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 460, datë 22.5.2013, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Pika 1, e kreut I, ndryshohet, me këtë përmbajtje:

“1. “Tokë”, në kuptim të këtij vendimi, nënkupton tokën që është pasuri shtetërore, klasifikuar në fondin e tokës bujqësore, sipërfaqet që, në dokumentacionin kadastral, figurojnë në kategorinë e resursit tokë bujqësore.”.

2. Kudo në vendim, fjalët “...tokë bujqësore në pronësi të shtetit...” zëvendësohen me fjalën “...tokë...”, sipas përkufizimit të dhënë në pikën 1, të këtij vendimi.

3. Në kreun II, “Objekti i qiradhënies”, bëhen këto ndryshime:

a) Pika 1 ndryshohet, me këtë përmbajtje:

“1. Objekt i qiradhënies, sipas këtij vendimi, janë të gjitha sipërfaqet e tokës në pronësi të shtetit.”.

b) Pika 3 shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama